

EKSPOZE E TEMËS SË DIPLOMËS MASTER:
**ROLI I QEVERISJES LOKALE NË KOMUNËN E PRISHTINËS NË
ZHVILLIMIN E NDËRMARRJEVE
TË VOGLA DHE TË MESME 2010-2020**

NGA

JETON SHKODRA



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I SHKENCËS POLITIKE

PROGRAMI MASTER

SHOQËRI CIVILE DHE ZHVILLIM LOKAL

Shtator, 2022

ROLI I QEVERISJES LOKALE NË KOMUNËN E PRISHTINËS NË ZHVILLIMIN E NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME 2010-2020

Mentor: Prof.Dr. Sejdi Rexhepi

Kandidati: Jeton Shkodra

Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) luan një rol të rëndësishëm, sidomos në shtetet e Ballkanit në përgjithësi, duke e përfshirë edhe Kosovën në veçanti. Si pjesë e punës hulumtuese për këtë temë masteri, është përzgjedhur roli i Komunës së Prishtinës që ka në zhvillimin e NVM-ve.

Objektivi i përgjithshëm i këtij punimi do të jetë: Roli i qeverisjes lokale në Komunën e Prishtinës në zhvillimin e NVM-ve, kurse si objektiva specifike do të jenë:

- ⇒ Roli dhe rëndësia e qeverisjes lokale në aspektin e infrastrukturës ekonomike;
- ⇒ Krijimi i kushteve për rritjen e NVM-ve;
- ⇒ Krijimi i kushteve për tërheqjen e investimeve;
- ⇒ Lidhshmëria e qeverisjes lokale me qeverisjen qendrore në ndikimin e zhvillimit ekonomik;

Pyetjet hulumtuese:

- ⇒ Sa ka ndikuar qeverisja lokale e Komunës së Prishtinës në zhvillimin e bizneseve të vogla?
- ⇒ Sa është shkalla e reduktimit të varfërisë në Komunën e Prishtinës?
- ⇒ Gjatë periudhës hulumtuese (2010-2020) sa ka qenë ndryshueshmëria e zhvillimit të NVM-ve në përqindje?
- ⇒ Në çfarë rrethana qeverisja lokale mund të ketë ndikim negativ në zhvillimin e NVM-ve?
- ⇒ Cilët faktor kanë ndikim më të lartë në zhvillimin e NVM-ve?

Hipotezat:

H1: Mbështetja e qeverisjes lokale ka një marrëdhënie pozitive me zhvillimin ekonomik lokal në Komunën e Prishtinës!

H2: NVM-të janë aktive në hartimin e strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal të Komunës së Prishtinës!

Hipotezat e mësipërme janë testuar nëpërmjet të dhënave të mbledhura nga realizimi i një ankete përmes pyetësorëve me NVM-të që operojnë në regjionin e Prishtinës. Përzgjedhja e të intervistuarve është bërë me metodën e rastit, dhe respondentët janë informuar se të dhënat e marra do të përdoren vetëm për qëllime kërkimore dhe nuk do të bëhen publike si të vetme!

Pyetësi ka qenë në përmbajtje me variabla si: gjinia, moshë, kualifikimi, vitet në biznes, lloji i biznesit, pjesëmarrja në diskutimet publike, implementimi i politikave zhvillimore, etj., dhe realizohet vetëm me NVM-të të cilat janë të regjistruar në agjensionin e regjistrimit të bizneseve në Kosovë (ARBK). Të dhënat statistikore janë përdorur për të analizuar të dhënat me një fokus të veçantë në frekuencat bazë-përshkruese dhe përqindjet e përgjigjeve për pyetjet e ndryshme në pyetësor. Po ashtu, mesatarja, devijimi standart dhe matrica e korrelacionit do të jenë pjesë e analizave statistike me qëllim të gjetjeve sa më të qendrueshme.

Ndërmarrje e vogël quhet ajo ndërmarrje që ka 10 – 49 të punësuar.

Ndërmarrje e mesme quhet ajo që ka 50 – 249 të punësuar.

Ky punim është i organizuar në katër kapituj.

Në kapitullin e parë - është përfshirë një shqyrtim i përgjithshëm mbi NVM-të dhe rëndësinë e tyre që kanë në zhvillimin ekonomik të një vendi e sidomos në atë lokal, pastaj rëndësinë e qeverisjes lokale për mbështetjen e NVM-ve duke përfshirë mundësitë e tyre duke parë dhe përshkruar burimet financiare të paraqitura në tabelë dhe figurë duke komentuar ato.

Në kapitullin e dytë – është paraqitur analiza e performancës së NVM-ve në Kosovë, ku është paraqitur në mënyrë statistikore dhe tabelare kjo gjë, duke përfshirë: ndërmarrjet e regjistruara dhe ato të shuara, ndërmarrjet sipas veprimtarive ekonomike, numrin e të punësuarve sipas sektorëve ekonomik, pagat mesatare etj. Poashtu në këtë kapitull është përfshirë zhvillimi ekonomik dhe politik i Prishtinës, që përmban bizneset që operojnë dhe zhvillimin dhe

regjistrimin e tyre, gjithashtu edhe tranzicionin politik të pasluftës si dhe rolin e shoqërisë civile në zhvillimin ekonomik të saj.

Në kapitullin e tretë – është përfshirë korniza ligjore për rregullimin e veprimtarisë së NVM-ve. Kjo pjesë ofron një përmbledhje të kornizës ligjore vendore relevante për fushën e ndërmarrjeve, NVM-ve dhe mjedisit të biznesit, me fokus në ligjet që rregullojnë mbështetjen për NVM-të, shoqëritë tregtare, shërbimet e inspektimit, tregtinë e brendshme dhe investimet e huaja. Ndryshimi dhe plotësimi i legjislacionit bazë krijon kushte për stimulimin e investimeve të huaja dhe heqjen e barrierave administrative, gjë që ju mundëson NVM-ve të veprojnë më lehtë dhe të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik.

Në kapitullin e katërt - është paraqitur analiza e rezultateve dhe analizimi i tyre nga intervistimi i bërë me disa NVM që operojnë në Prishtinë. Pytësori ka qenë i përgatitur me pyetjet të citat na ka ndihmuar në përgjigjet e subjekteve tona të hulumtimit, si dhe në realizimin e objektivave tona të parashtruara. Pytësori përfshin të dhënat demografike të NVM si: vitet në biznes, gjinia, mosha, kualifikimi, lloji i biznesit, pjesëmarrja në diskutimet publik, implementimi i politikave zhvillimore, etj. Statistikat janë përdorur për të analizuar të dhënat me një fokus të veçantë në frekuencat bazë përshkruese dhe përqindjet e përgjigjeve ndaj pyetjeve të ndryshme në pyetësor.